



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 362 Prot.

Tiranë, më 09/02/2023

VENDIM

Nr. 01, datë 09.02.2023

PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË
STUDIMEVE DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2024 - 2025**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik, neni 9, si dhe në propozimet e fakulteteve për kriteret e pranimit në programet përkatëse të ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2024-2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 09.02.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit, për vitin akademik 2024-2025, në programet e ciklit të parë të studimit, Bachelor, dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, si më poshtë:

A.

1. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Mekanike
2. Bachelor në Inxhinieri Materiale
3. Bachelor në Inxhinieri Tekstili dhe Mode
4. Bachelor në Inxhinieri Ekonomike

2. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatike
2. Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare
3. Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit
4. Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi
5. Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike

3. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi
2. Bachelor në Inxhinieri Hidroteknike
3. Bachelor në Inxhinieri Mjedisi
4. Bachelor në Inxhinieri Gjeodet

4. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinierinë Matematike
2. Bachelor në Inxhinierinë Fizike

kanë vendosur këto kritere:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2024 – 2025, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë” neni 74, pika 1).

- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{(\text{VKM})} + 0.3(0.5 * \text{Mes}_{(\text{Matematike})} + 0.4 * \text{Mes}_{(\text{Fizike})} + 0.1 * \text{Mes}_{(\text{Kimi})})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

$\text{Mes}_{(\text{VKM})}$, nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2024 – 2025, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë” neni 74, pika 1;

$\text{Mes}_{(\text{Matematike})}$, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

$\text{Mes}_{(\text{Fizike})}$, nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

$\text{Mes}_{(\text{Kimi})}$, nota mesatare e thjeshtë e kimisë në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

$K_{\text{koef. Shkollës}}$, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2024 – 2025, sipas tabelës së koeficientëve për vitin akademik 2024 – 2025.

B.

1. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Elektronike
2. Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve
3. Bachelor në Inxhinieri Informatike

2. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Automatizim i Industrisë
2. Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë
3. Bachelor në Inxhinieri Mekatronike

kanë vendosur këto kritere:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2024 – 2025, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë” neni 74, pika 1.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{\text{VKM}} + 0.3(0.6 * \text{Mes}_{\text{Matematike}} + 0.4 * \text{Mes}_{\text{Fizike}})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

Mes_{VKM} , nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2024 – 2025, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë” neni 74, pika 1;

$\text{Mes}_{\text{Matematike}}$, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

$\text{Mes}_{\text{Fizike}}$, nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

$K_{\text{koef. Shkollës}}$, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2024 – 2025, sipas tabelës së koeficientëve për vitin akademik 2024 – 2025.

C.

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, për programet e integruara të studimit:

1. Master i Shkencave në Arkitekturë, Profili Arkitekt
2. Master i Shkencave në Arkitekturë, Profili Urbanist

dhe për programin e studimit të ciklit të parë:

1. Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn

ka vendosur këto kritere:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2024 – 2025, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë” neni 74, pika 1.
- Kandidatët do t’i nënshtrohen një testi në hyrje të organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$0.4 * \text{Mes}_{\text{VKM}} * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000 + 0.6 * T_{\text{(Testi)}} * 100$$

Mes_{VKM} , nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2024 – 2025, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë” neni 74, pika 1;

K_{koef. shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2024-2025.

T_(Testi), rezultati i testimit, i cili përbëhet nga katër (4) komponentë:

- | | |
|--------------------------------------------------|--------------------------------------|
| • Test i arsytimit logjik | 25% T _(Testi) , (25 pikë) |
| • Test i kulturës së përgjithshme | 25% T _(Testi) , (25 pikë) |
| • Test i historisë dhe historisë së arkitekturës | 25% T _(Testi) , (25 pikë) |
| • Test i vizatimit dhe prezantimit | 25% T _(Testi) , (25 pikë) |

2. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave për të shpallur publikisht kriteret e pranimit në faqen zyrtare të UPT dhe në portalin U-Albania.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari

